



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 78, datë 12.07.2022

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 55, DATË 31.05.2022
“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT
PREJ 21561573.6 (NJËZETË E NJË MILION E PESËQIND E GJASHTËDHJETË E
NJË MIJË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E TRE PIKË GJASHTË) LEKË, PËR
PASURITË, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK
ME OBJEKT : “ RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA ” (PARALEL ME LINJËN
HEKURUDHORE – PLAZH)”**

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 395, datë 13.05.2021 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”, sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Pas pikës 2 , të vendimit nr. 55, datë 31.05.2022, të Këshillit Bashkiak, shtohet pika 2.2, si më poshtë vijon:

“Miratimin e relacionit mbi zbatimin e urdhrin nr. 469, datë 16.09.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstruksion rruga “Apulia” (paralel me linjën hekurudhore – Plazh), i ndryshuar me urdhrin nr. 110, datë 18.03.2022”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve,

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 13.07.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Nr. 2471/1 Prot.

Durrës, më 26/09 / 2022

MIRATOHET

KRYETAR

Emiriana Sako



MBI ZBATIMIN E URDRIT NR. 469, DATË 16.09.2021 "PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VLERËSIMIN PARAPRAK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT "RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA" (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH), I NDRYSHUAR ME URDRIN NR. NR. 110, DATË 18.03.2022

Referuar Urdhrit nr. 469, datë 16.09.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: "Rikonstrukcion rruga "Apulia" (paralel me linjën hekurudhore – plazh), i ndryshuar me urdhrin nr. 110, datë 18.03.2022, grupi i punës i përbërë nga znj. Eni Turkeshi, (kryetar), z. Aleks Prenga dhe znj. Ardita Molla anëtar, për realizimin e detyrës së ngarkuar është bazuar në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku neni 41 përcakton "...e drejta e pronës është e garantuar; Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publik; Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që bazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë; Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë....".
- Ligji nr. 8561, datë 22.11.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.
- VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- Akte të tjera nënligjore, që lidhen me ligjin e posaçëm të shpronësimeve për interes publik.

Kjo bazë ligjore ka sherbyer për të përcaktuar pronarët e pronës që kërkohet të shpronësohen, së bashku me të dhënat specifike të vendodhjes së pronës, si dhe vlerën e pasurisë që kërkohet të shpronësohet. Për zbatimin e detyrës së ngarkuar, grupi i punës u bazua në gjurmën projektit, e miratuar me leje infrastrukture nr. 2206, datë 20.8.2021 dhe në hartën Asig Gjeoportali, nga ku rezultoi se gjurma e projektit prek 31 pasuri si më poshtë:

PASURI ME GJENDJE JURIDIKE PRIVAT:

- Pasuria Nr. 48/14, ZK 8518, me sipërfaqe 1967 m².
- Pasuria Nr. 48/20, ZK 8518, me sipërfaqe 3870 m².
- Pasuria Nr. 48/37, ZK 8518, me sipërfaqe 500 m².
- Pasuria Nr. 48/51, ZK 8518, me sipërfaqe 300 m².
- Pasuria Nr. 48/19, ZK 8518, me sipërfaqe 1065 m².
- Pasuria Nr. 48/13, ZK 8518, me sipërfaqe 1200 m².

PASURI ME GJENDJE JURIDIKE SHTET:

- Pasuria Nr. 43/131, ZK 8518, me sipërfaqe 480 m².
- Pasuria Nr. 43/131, ZK 8518, me sipërfaqe 627 m².
- Pasuria Nr. 43/139, ZK 8518, me sipërfaqe 779 m².
- Pasuria Nr. 45/86, ZK 8518, me sipërfaqe 637 m².
- Pasuria Nr. 45/111, ZK 8518, me sipërfaqe 29 m².
- Pasuria Nr. 45/105, ZK 8518, me sipërfaqe 579 m².
- Pasuria Nr. 45/112, ZK 8518, me sipërfaqe 776 m².
- Pasuria Nr. 45/121, ZK 8518, me sipërfaqe 204 m².
- Pasuria Nr. 45/123, ZK 8518, me sipërfaqe 88 m².
- Pasuria Nr. 45/124, ZK 8518, me sipërfaqe 91 m².
- Pasuria Nr. 45/126, ZK 8518, me sipërfaqe 150 m².
- Pasuria Nr. 45/129, ZK 8518, me sipërfaqe 168 m².
- Pasuria Nr. 48/28, ZK 8518, me sipërfaqe 23 m².
- Pasuria Nr. 48/29, ZK 8518, me sipërfaqe 363 m².
- Pasuria Nr. 48/30, ZK 8518, me sipërfaqe 374 m².
- Pasuria Nr. 48/32, ZK 8518, me sipërfaqe 337 m².
- Pasuria Nr. 48/31, ZK 8518, me sipërfaqe 763 m².
- Pasuria Nr. 48/36, ZK 8518, me sipërfaqe 795 m².
- Pasuria Nr. 48/38, ZK 8518, me sipërfaqe 365 m².
- Pasuria Nr. 48/39, ZK 8518, me sipërfaqe 311 m².
- Pasuria Nr. 48/48, ZK 8518, me sipërfaqe 489 m².
- Pasuria Nr. 49/2, ZK 8518, me sipërfaqe m².
- Pasuria Nr. 43/133, ZK 8518, me sipërfaqe 250 m².

Bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.11.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dalë në bazë e për zbatim të ligjit, grupi i punës u përqëndrua në marrjen e informacionit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, për gjendjen juridike të pasurive që preken nga projekti, duke shoqëruar informacionin me kopje të hartës dhe kartelë pasurie. Korrespondenca me ASHK-në është kryer nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve pranë bashkisë në adresën elektronike

[Handwritten signatures and stamps]

4

e-mail. Po nga ky Sektor u krye azhurnimi i listës së pasurive që preken nga investimi nëse janë pjesë e listës së transferimit të pronave tek Bashkia Durrës, duke zbritur nga lista këto pasuri.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës i është përgjigjur kërkesës së Bashkisë për informacion dhe dokumentacion me shkresën nr. 249/1 prot., datë 21.01.2022, duke na bërë me dije informacionin për gjendjen juridike të pasurive të kërkuara, duke e shoqëruar informacionin me kopje të hartës dhe kartelë pasurie, si më poshtë:

- Pasuria Nr. 48/14, ZK 8518, me sipërfaqe 1967 m², është në bashkëpronësi të: Lejla Teufik Haznedari; Violeta Teufik Manushi; Hasan Teufik Kalatsi; Klebeta Sabri Kalatsi; Denada Sabri Negollari.
- Pasuria Nr. 48/20, ZK 8518, me sipërfaqe 3870 m², është në bashkëpronësi të: Arianita Gezim Hasa; Bujare Hasa; Fatmir Hasa; Kujtim Hasa; Mynyre Hasa; Neta Hasa; Teuta Starova; Tomorr Hasa.
- Pasuria Nr. 48/37, ZK 8518, me sipërfaqe 500 m², është në pronësi të Nezir Rama.
- Pasuria Nr. 48/51, ZK 8518, me sipërfaqe 300 m², është në pronësi të Andrea Nazniku.
- Pasuria Nr. 48/19, ZK 8518, me sipërfaqe 1065 m², është në bashkëpronësi të: Dhurata Magjistari; Elin Magjistari; Thellenxa Koçi; Kimete Gjika; Lumturi Xhabija; Maksim Haxhiu; Merushe Haxhiu; Miguel Magjistari; Silvana Leka; Xheni Agovi;
- Pasuria Nr. 48/13, ZK 8518, me sipërfaqe 1200 m², është në bashkëpronësi të: Kimete Gjoka; Dhurata Magjistari; Martin Magjistari; Miguel Arbër Magjistari; Elin Magjistari; Silvana Leka; David Leka; Maksim Haxhiu; Merushe Haxhiu; Thellenza Koçi; Lumturi Xhabija; Xheni Agovi.

Nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës është marrë informacioni dhe për pasuritë me gjendje juridike shtet, që janë 25 pasuri, sipas përshkrimit të sipërshtuar.

Ndërsa për përcaktimin e çmimit për metër katror të tokës "truall", bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.11.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, nga ana Sektorit të Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve me shkresë nr. 11118 prot., datë 13.10.2021, i është kërkuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, informacion për çmimin për metër katror të disa llojeve pasurish, që preken nga investim publik.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës me shkresë nr. 10519 prot., datë 26.11.2021 i është përgjigjur kërkesës sonë për informacion, ku ndër të tjera për llojin e pasurisë tokë "truall" na bënë me dije se çmimi për metër katror për ZK 8518 është 19336 lekë. Informacioni i ardhur është bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016. Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Grupi i punës, bazuar në verifikimin në terren, ballafaquar me projektin e miratuar, informacionit të marrë nga Asig Gjeoportali për pasuritë që preken nga investimi, si dhe informacioni si për pronarët e këtyre pasurive, si dhe çmimin e tokës "truall" për metër katror, e marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, hartoi listën paraprake të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion rruga "Apulia" (paralel me linjën hekurudhore – Plazh).

Për vlerësimin e pasurisë së llojit tokë "truall", grupi i punës është bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", kjo si një përcaktim që që i bën ligji nr. 8561, datë 22.11.1999.

Grupi i punës vendosi që në listën e pasurive që preken nga ky investim të pasqyrohen dhe pasuritë me gjendje juridike shtet dhe kjo me qëllimin e rakordimit me institucionet shtetërore që i kanë në administrim këto pasuri, që të reflektohet në rregjistrat përkatëse.

Vlera totale e shpronësimit është 21561573.6 (njëzetë e njëmilion e pesëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë) lekë, e pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI
 "RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA" (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH)

Nr	Pronari			Të dhënat Mbi pasurinë sipas ASHK-së				Vlerësimi për Shpronësim sipas llojit të pasurisë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. pas.	Lloji pas.	Sip. Totale (m ²)	Shpronësim tokë "truall"			
								Sip. që shpronësohet (m ²)	Çmimi Lekë/m ²	Vlera Totale (lekë)	
1	Bashkëpronarët: Lejla Teufik Hazedari Violeta Teufik Manushi Hasan Teufik Kalatsi Klebeta Sabri Kalatsi Denada Sabri Negollari			8518	48/14	Truall	1967	404	19336	7811744	Konfirmuar nga ASHK, DV Durrës
2	Bashkëpronarët: Arianita Gezim Hasa Bujare Hasa Fatmir Hasa Kujtim Hasa Mynyre Hasa Neta Hasa Teuta Starova Tomorr Hasa			8518	48/20	Truall	1967	214	19336	4137904	Konfirmuar nga ASHK DV Durrës
3	Nezir Vjosa			8518	48/37	Truall	500	19	19336	367384	Konfirmuar nga ASHK, DV Durrës
4	Andrea Nazniku			8518	48/51	Truall	300	6.1	19336	117949.6	Kufizohen veprimet për këtë pasuri deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor
5	Bashkëpronarët: Dhurata Magjistari Elin Magjistari Fellenza Koçi Kimete Gjoka Lumturi Xhabija Maksim Haxhiu Merushe Haxhiu Miguel Magjistari Silvana Leka Xheni Agovi			8518	48/19	Truall	1967	415	19336	8024440	Konfirmuar nga ASHK, DV Durrës

6	Bashkëpronarët: Kimete Gjoka Dhurata Magjistari Martin Magjistari Miguel Arbër Magjistari Elin Magjistari Bashkëpronarët: Silvana Leka David Leka Maksim Haxhiu Merushe Haxhiu Thellenza Koçi Lumturi Xhabija Xheni Agovi	8518	48/13	Truall	1200	57	19336	1102152	Konfirmuar nga ASHK, D.V Durrës
Vlera totale paraprake						----	19336	21561573.6	

Shënim: Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga Vendimi nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"

Bashkëlidhur Relacionit:

- Urdhërin nr.469, datë 16.09.2021.
- Urdhri i ndryshuar nr. 110, datë 18.03.2022.
- Projekti, gjurma e projektit, e miratuar me leje infrastrukture nr. 2206, datë 20.8.2021.
- Shkresa nr. 249/1 prot., datë 21.01.2022, ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, që bënë fjalë për informacion për gjendjen juridike të pasurive të kërkuara, duke e shoqëruar informacionin me kopje të hartës dhe kartelë pasurie.
- Shkresë nr. 10519 prot., datë 26.11.2021, ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, ku i përgjigjet kërkesës sonë për informacion, ku ndër të tjera për llojin e pasurisë tokë "truall" na bënë me dije se çmimi për metër katror është 19336 lekë.
- Informacion, Kartelat e pasurisë, së bashku me fragment harte për 6 pasuri që preken nga investimi.
- Planvendosjet e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga investimi.


PUNUAN:

Eni Turkeshi (kryetar)



Aleks Prenga (anëtar)



Ardita Molla (anëtar)






**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 570/18 prot.

Durrës, më 20 07 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.78 datë 12.07.2022 Për një shtesë në VKB Nr.55 dt 31.05.2022 “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 21.561.573.6 (njëzet e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë) lekë, për pasuritë, pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstruksion Rruga Apulia” (paralel me linjën hekurudhore – Plazh)”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMIL JANJANI

